



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna Rahovec
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Kryetari i Komunës - Predsedin Opštine - Municipality Mayor

PLANI VJETOR I PUNËS SË KRYETARIT DHE QEVERISË KOMUNALE



(Janar - Dhjetor 2018)

Përmbajtja

ZOTIMI IM NË FILLIM TË MANDATIT	2
DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME.....	3
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE	6
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM	6
DREJTORIA PËR FINANCË DHE BUXHET	7
DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM	8
DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	9
DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË.....	10
DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE.....	11
DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL	13
DREJTORIA PËR PUNE INSPEKTUESE	14
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	16
DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM	18

ZOTIMI IM NË FILLIM TË MANDATIT

“Krijimi i kushteve më të mira për investime në ekonomi, kthimi i hapësirave nga menaxhimi i APK (Agjencioni Pyjor i Kosovës) në menaxhim nga Komuna, bujqësi e zhvilluar, infrastrukturë të rregulluar, përmirësimi i shëndetit dhe mirëqenies sociale, edukim, arsimim dhe shërbime të cilësisë së lartë për qytetarët tanë”

Prioritetet kryesore:

- Komunë e qëndrueshme dhe institucione funksionale
- Rritje e përkrahjes për bujqësinë
- Administratë efikase, e përgjegjshme dhe modernizimi i shërbimeve
- Dinamikë e lartë e punës së qeverisë dhe vendimmarrje pa vonesa
- Angazhim i vendosur për t’i dhënë zgjidhje palestrës së sporteve në qytet
- Përkrahje serioze sportit
- Terrene sportive
- Angazhim dhe bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës për t’i kaluar në shfrytëzim të përhershëm komunës së Rahovecit pronat e Agjencisë Pyjore të Kosovës të cilat i ka në shfrytëzim, me qëllim krijimin e zonës ekonomike dhe të zonës së turizmit të Rahovecit.
- Shlyerja e obligimeve financiare dhe zbatimi i kontratave të trashëguara
- Realizimi i suksesshëm i buxhetit për vitin 2018
- Rritje e përkrahjes financiare nga Qeveria e Kosovës
- Bashkëpunim me donatorët e jashtëm
- Komunikimi dhe debati me qytetarët dhe grupet e interesit
- Bashkëpunim me OJQ-të
- Aktivitete të vazhdueshme dhe dinamizim i jetës kulturore
- Angazhim për rritjen e të hyrave komunale
- Plane konkrete të punës për të rritur efikasitetin e institucioneve dhe cilësinë e shërbimeve për qytetarët
- Hartimi i PZHK-së dhe Hartës Zonale
- Mjedis i pastër dhe i gjelbëruar
- Angazhim për trajtimin e ujërave të zeza, furnizim më të mirë me ujë të pijshëm
- Ndërtim të rrugëve të reja dhe mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese
- Mirëmbajtje e hapësirave publike
- Rritje e cilësisë dhe investime në arsim
- Bursa për studentë
- Investime në nyjat sanitare dhe meremetim të shkollave
- Rritje e cilësisë dhe kohëzgjatja e shërbimeve në mjekësinë primare
- Vizita sistematike shëndetësore nëpër të gjitha shkollat

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME

Në kuadër të drejtorisë së Administratës së Përgjithshme ekzistojnë këta sektorë:

- Administrata
- Gjendja Civile
- Sektori i teknologjisë informative – IT
- Sektori për punët e kuvendit
- Zyra për të drejtat e njeriut
- Zyra për barazi gjinore
- Zyra për integritet evropiane

Administrata

Takim me të gjithë punonjësit e komunës së Rahovecit. Takimet do të jenë sistematike dhe planifikohen të mbahen çdo 3 muaj, ku do të kërkohen nga të gjithë punëtorët e administratës që të respektojnë orarin e punës si dhe të gjitha urdhëresat që do të nxirren nga kryetari i Komunës.

Do të vizitohen të gjitha zyrat e gjendjeve civile në bashkësi lokale, në mënyrë planifikohet që të mbahet rendi dhe zyrtarët komunalë të jenë gjithmonë në shërbim të qytetarëve.

Në kuadër të projekteve për administratën e përgjithshme, theksi do bie në ofrimin e shërbimeve elektronike, ndikim direkt në këtë do të ketë E-kiosku që synojmë ta realizojmë gjatë vitit 2018.

Korriku dhe gushti do të shpallen si muajt e mërgimtarëve, ku përveç aktiviteteve kulturore - artistike, në administratë do të rriten dhe zgjaten shërbimet për qytetarë, e do të hapet edhe një sportel i veçantë për mërgimtarë.

Gjendja Civile

Ofrimi i shërbimeve të shpejta është synim i yni gjatë vitit 2018. Do të kujdesemi që stafi të jetë i përgatitur me njohuri, gjithmonë duke u bazuar në ligjet aplikative.

Do të bëhet një ristrukturim i personelit dhe sporteleve në mënyrë që funksionaliteti dhe shërbimi të jetë maksimal.

Sektori i Teknologjisë Informative

Sektori i teknologjisë informative padyshim që është ndër sektorët me shumë rendësi për funksionim të administratës në përgjithësi.

Fillimisht do të kujdesemi që të gjithë zyrtarët dhe drejtorët e drejtorive të jenë të pajisur me pajisje të nevojshme për punë administrative në zyrë. Pajisja me e-mail zyrtar për të gjithë stafin dhe drejtorët e drejtorive, po ashtu edhe për kuvendarët e rinj.

Shfrytëzimi racional dhe suportimi i stafit në aktivizim të Intranetit.

Pajisjen e zyrtarëve komunal me ID kartela

Përditësimi dhe plotësimi i WEB-faqes së komunës së Rahovecit me të gjitha informatat, vendimet, urdhëresat, në mënyrë që transparenca ta ketë fjalën kryesore. Po ashtu do të vendoset një monitor në hapësirën e administratës së komunës, ku do të publikohen informata me rëndësi nga qeverisja komunale.

Spektori për Punë të Kuvendit

Në kuadër të zyrës për punët e kuvendit parashihet që të përgatiten dhe organizohen seancat e rregullta, seancat e jashtëzakonshme dhe seancat emergjente.

Përgatitja e materialit dhe fletëvotimeve për mbledhjet e Kuvendit, për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit, dërgimi i materialit dhe ftesës MAPL-së dhe kuvendarëve me anë të e-mailit dhe ftesave fizike për datën e mbledhjes. Të gjitha vendimet e nxjerra nga kuvendi do të procedohen më tutje sipas rregulloreve dhe ligjeve në fuqi, të njëjtat do të kujdesemi që të arkivohen në mënyrën më të mirë të mundshme.

Njësia komunale për të drejtat e njeriut

Në planin e punës për periudhën janar – dhjetor 2018, përfshihen aktivitetet që do të realizohen në fushën e të drejtave të njeriut.

Përmbajtja e përfshirë në planin një-vjeçar të cilin po e prezantojmë është bazuar edhe në statistikën e grumbulluar nga bashkëpunëtorët relevant, me të cilët NJKDNJ është në kontakt të vazhdueshëm dhe ka një shkëmbim dhe bashkëpunim të frytshëm, veçmas me Drejtorinë e Arsimit dhe atë të Shëndetësisë/QPS-në, Policinë dhe të tjerët. Nuk do të mungojë bashkëpunimi me zyrtarë të zyrës së Avokatit të Popullit.

Ditët e hapura planifikohet që të mbahen me qytetarë nëpër qendrat në nivel komune, ku do të bëhet promovimi i të Drejtave të Njeriut, gjegjësisht të drejtat e fëmijëve.

I tërë plani nënvizon rëndësinë e nxitjes së koordinimit dhe rritjes së bashkëpunimit me të gjithë akterët e përfshirë në çështjet e të drejtave të njeriut, me qëllim të angazhimit dhe dëshmisë ndaj reagimit të përbashkët ndaj diskriminimit në institucionet komunale dhe hartimin e politikave të reja komunale me fokus mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përgjithësi.

Njësia për të drejtat e njeriut në Komunën e Rahovecit do të punojë edhe në fushën e ri-integrimit të personave të riatdhesuar .

Zyra komunale për barazi gjinore

Punët dhe detyrat e parapara me plan vjetor do të kryhen me efikasitet, përgjegjësi dhe profesionalizëm në harmoni me përcaktimin e detyrave të punës.

Në zyrën për Barazi Gjinore, do të kryhen këto punë:

Do të asistohen të gjitha rastet e të ri-atdhesuarve për plotësimin e dokumenteve për të qenë përfitues të programit të riatdhesuar në bashkëpunim me zyrën e punësimit në Rahovec. Gjatë gjithë vitit personat e ri-atdhesuar të cilat përfitojnë grante, do të monitorohen.

Në bashkëpunim me grupin joformal të grave do të bëjmë agjendën në bashkëpunim me zyrën e kryetarit për organizimin e festës së gruas 8 Marsin. Do të organizojmë takime rajonale me OSCE dhe organizata të ndryshme që merren me barazi gjinore.

Gjatë gjithë vitit planifikohet që rastet e dhunës familjare të raportohen në Stacionin Policor në Rahovec.

Bizneset që udhëhiqen nga femrat planifikojmë t'i vizitojmë gjatë vitit në mënyrë sistematike.

Zyra për integritet evropiane

Zyra për Integritet evropiane do të kryej funksionin dhe detyrat e veta, duke u bazuar në rregulloren nr. 08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për integritet evropian, në monitorimin, bashkëpunimin dhe raportimin e rregullt për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Departamentin për Integritet Evropiane.

ZKIE do të merr pjesë në të gjitha grupet punuese dhe takimet e rregullta që do të mbahen gjatë periudhës një vjeçare për përpilimin dhe ndarjen e obligimeve që dalin për komunat nga raporti i vendit në përmbushjen e obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane, duke u bazuar në programin kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit (PKZMSA-së), takimet e organizuar, nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

Gjatë kësaj periudhe kohore ZKIE do të përgatit të dhënat nga drejtoritë përkatëse në kuadër të komunës për detyrat që dalin nga PKZMSA-ja, dhe do të diskutojmë për obligimet e parapara që janë nën kompetencën e komunave dhe nëse kanë ndonjë vërejtje të bëhen në draftplan.

ZKIE do të jetë pjesëmarrëse në rishqyrtimin e Planit të Punës së Kolegjiumit të zyrtarëve komunalë për integritet evropiane për vitin 2018 dhe programin legjislativ në Asociacionin e Komunave të Kosovës.

Trajnim-Zbatimi i Strategjisë shtetërore për ri-integritet të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar 2018-2022 dhe planin e veprimit 2018-2020. Trajnim-zbatimi i dokumenteve kryesore të Politikave për Ri-integritet.

Roli i komunave në përmbushjen e obligimeve nga Agjenda Evropiane si dhe zbatimi i Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026.

Pranimi i kërkesave dhe përgatitje e lëndëve të personave të ri-atdhesuar për akomodim, plan-biznesi, rindërtim dhe së bashku me koordinatorin rajonal edhe monitorimin e plan-bizneseve.

Zyrtari për Integritet Evropiane në komunën e Rahovecit do të fokusohet dhe përkushtohet në detyrat dhe funksionet e tij, gjithnjë duke bërë përpjekje që të forcojë dhe përmirësojë bashkëpunimin, monitorimin, këshillimin, si me autoritetet qendrore, ashtu edhe me kabinetin e kryetarit, drejtoritë, zyret komunale si dhe shoqërinë civile.

DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në kuadër të drejtorisë së shëndetësisë në komunën tonë, funksionojnë dy sektorë:

- Sektori për shëndetësi
- Sektori për mirëqenie sociale

Plani vjetor i punës i DSHMS-së është i fokusuar në:

- Ofrimin e shërbimeve sa më cilësore në shëndetësi;
- Takime dhe komunikim të rregullt me gjithë personelin, që të kemi një dinamikë ndryshe, me qëllim që të ketë disiplinë, respektim të orarit të punës, rregull si dhe administrim më të përgjegjshëm të resurseve humane dhe materiale të cilat janë përgjegjësi dhe detyrë e mjekësisë parësore, në mënyrë që të vihen në shërbim të plotë për të gjithë qytetarët tanë në nevojë;
- Investime kapitale, kryesisht për ndërtimin e objektit të qendrës kryesore të mjekësisë familjare dhe emergjencë, ndërtimin e AMF-ve;
- Investimet në teknologjinë mjekësore për ofrimin e shërbimeve më cilësore;
- Ofrimin e shërbimeve shtesë dhe të karakterit mobil si dhe kohëzgjatjen e tyre në dy QMF (Krushë e Madhe dhe Ratkoc) përmes Caritas Kosova, krahas të cilave mundësohet ofrimi i shërbimit edhe për personat në regjim shtrati. Pra, mbetet objektiv yni angazhimi i dhjetëra mjekëve, fizioterapeutit, teknikëve medicinalë etj.;
- Planin strategjik për parandalimin e etheve hemorragjike (Krime Kongo dhe rriqrat);
- Angazhim për thithjen e donacioneve nga jashtë (autoambulanca për nevojat e QKMF-së, investime në pajisje mjekësore etj.;
- Kujdes i vazhdueshëm për barnat esenciale;
- Vizita të organizuara në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të komunës;
- Vendosjen e kamerave të sigurisë në objektet shëndetësore;
- Renovimin e objekteve shëndetësore dhe të nyjave sanitare;

Angazhim për hapjen e repartit të hemodializës në Rahovec.

DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM

Drejtorja për Arsim planifikon të realizojë një mori të aktiviteteve me qëllim të përmirësimit të kushteve infrastrukturore dhe cilësisë në fushën e arsimit.

- Takim me të gjithë drejtorët e shkollave në nivel të komunës;
- Incizimi i gjendjes faktike të objekteve shkollore;
- Shkresa dhe kërkesa për MASHT për ndihmë financiare;
- Identifikimi i problemeve në mbarëvajtjen e procesit mësimor;

- Marrja e masave për ulje të mungesave të pa arsyeshme të nxënësve në shkollë;
- Sigurimi i transportit për nxënës që udhetojnë më shumë se 4 km;
- Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe garave me nxënës;
- Ndarja e bursave për studentë të dalluar;
- Implementim i projekteve që janë në vazhdim;

Për t'i arritur këto synime, do të ndërmerren këto veprime:

- Do të bëjmë investime në përmirësimin e kushteve infrastrukturore të shkollave në funksion të rritjes së cilësisë në arsim dhe do të fillojmë ndërtimin e shkollave të reja.
- Do të interesohemi për investime në mjete konkretizimi, laboratorë, teknologji informative dhe furnizime të bibliotekave shkollore me libra.
- Me fillimin e vitit të ri mësimor në shtator, do të bëhet funksionalizimi i plotë dhe i përhershëm i organeve drejtuese të shkollave, Këshillave Drejtuese të Shkollave, Këshillave të Prindërve dhe Këshillave të Nxënësve.
- Më tej do të bëjmë përpjekje që shkollave t'ju ofrojmë shërbimet profesionale pedagogjike dhe psikologjike si dhe do të angazhohemi në ofrimin e trajnimeve profesionale të mësimeve në funksion të rritjes së cilësisë në arsim.

DREJTORIA PËR FINANCË DHE BUXHET

Prioritetet, veprimet dhe aktivitetet kryesore:

- Përgatitja e planit për pranim-dorëzim të faturave në O.B. të Komunës;
- Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë;
- Plan-strategjia e realizimit të të hyrave komunale në raport me planifikimin;
- Përgatitja e KAB-it komunal 2019-2021, sipas qarkoreve buxhetore I dhe II;
- Debatet me qytetarë dhe dëgjimet buxhetore nga ekzekutivi si dhe nga KPF, periodha qershor-korrik;
- Përgatitja e raportit gjashtëmujor financiar për kuvend dhe për publik;
- Dërgimi i raportit të auditimit për vitin 2017 në kuvend, i audituar nga ana e Auditimit Kombëtar;
- Futja e të dhënave buxhetore në sistemin PIP dhe BDMS;
- Dorëzimi i KAB-it komunal 2019-2021, i përgatitur për votim në kuvend;
- Përgatitja e raportit nëntëmujor financiar për kuvend dhe për publik;
- Mbyllja e Vitit Fiskal 2018, me përqindje të lartë të shpenzimit të buxhetit dhe me një përqindje të lartë të realizimit të të hyrave;

Sfidë reale në këtë drejtori do të jetë zvogëlimi i borxheve të bartura nga vitet e kaluara si dhe hartimi i një strategjie për inkasimin e këtyre borxheve.

Qëllim kryesor: rritja e të hyrave të përgjithshme komunale në raport me planifikimin, realizimi i shpenzimit të buxhetit në masën 100% dhe plotësimi i rekomandimeve të bëra nga ana e auditorit kombëtar.

DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, në kuadër të aktiviteteve të planifikuara vjetore, funksionon me këta sektorë.

- Sektori për Ekonomi
- Sektori për Turizëm

Sektori i Ekonomisë

Në komunën e Rahovecit janë të regjistruar mbi 3,000 biznese të cilat aktivitetet e tyre i zhvillojnë në sektor të ndryshëm. Ndër sektorët me rëndësi të madhe është sektori i agrobiznesit të cilit do t'i jepet përkushtim i theksuar në punën tonë gjatë vitit 2018.

Synim i yni është që të krijohen zona ekonomike në pjesët më të përshtatshme të komunës së Rahovecit.

Do të bëjmë përpjekje maksimale që projekti për zonën ekonomike në pjesën mbi Opterushë të merr epilog, dhe në atë pjesë të fillon shtrirja e bizneseve me aktivitetet e tyre.

Në kuadër të drejtorisë planifikojmë që të formohen komisione të cilat njëherë e përgjithmonë do të eliminojnë të gjeturat e auditorit të jashtëm për regjistrim të aseteve të komunës.

Po ashtu do të formohen edhe komisione të tjera që kanë për qëllim evidentimin e pasurive jo financiare nën vlerën, 1,000 €.

Ndër hapat e parë që do të ndërmerren është hapja e tryezës këshillimore për biznese në kuadër të komunës së Rahovecit.

Do të përdoren metoda të ndryshme për inkasim të taksave afariste komunale, në mënyrë që të kemi një buxhet të qëndrueshëm financiar. Gjithashtu do të hartohet një plan operativ që do të ketë impakt të drejtpërdrejt në zvogëlim të borxhit të trashëguar ndër vite.

Pasuritë e komunës që janë të dhëna me qira do t'ju ofrojmë kushte më të mira, njëkohësisht do të synojmë në përkrahjen e tyre me rregullim të infrastrukturës, në mënyrë që ata të kenë mundësi të zhvillojnë aktivitetet e tyre biznesore.

Sa i përket zyrës për regjistrim të bizneseve, do të ndërmarrim masa në përmirësim dhe lehtësim të procedurave dhe kushteve për hapjen e bizneseve të reja.

Sektori i turizmit

Duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal (PZHK), komuna e Rahovecit ka të përcaktuar zonën turistike. Në këtë zonë synojmë që të zhvillojmë projekte që lidhen direkt me turizmin rural dhe kulturor.

Planifikojmë që ta funksionalizojmë zyrën e turizmit dhe e njëjta të bartet në një ambient më të përshtatshëm, ku vizitorët do të kenë mundësi të informohen për aktivitetet dhe pikat turistike të komunës sonë.

Synimet:

- Krijimi i zonave ekonomike.
- Hapja e tregjeve të reja
- Krijimi i pikave të turizmit rural

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit funksionon në dy sektorë:

- Sektori i Urbanizmit dhe Planifikimit
- Sektori i Mjedisit

Në kuadër të këtyre dy sektorëve shqyrtohen kërkesat e qytetarëve siç janë: Lejet ndërtimore, Lejet e rrënit, Kushtet ndërtimore, Lejet mjedisore komunale, Pëlqimet, Njoftimet e shkresa të ndryshme rreth zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe planeve të tjera rregulluese si dhe mbrojtjes së mjedisit.

Prioritet për këtë vit sipas planit të punës së kësaj drejtorie janë:

- Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal sipas komponentëve të ligjit të ri të planifikimit hapësinor dhe në bazë të programit për hartimin e këtij plani të miratuar nga kuvendi komunal në Rahovec;
- Hartimi i Hartës Zonale të komunës së Rahovecit;
- Krijimi i hapësirave të gjelbëruara dhe mbjellja e drunjëve dekorativ;
- Rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe përroskave në komunën e Rahovecit;
- Identifikimi dhe largimi i deponive ilegale, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike;
- Renovimi dhe fasadimi i objekteve publike në Rahovec,
- Shënimi i ditëve ndërkombëtare që lidhen me mbrojtjen e mjedisit;
- Shqyrtimi i lëndëve në afat minimal, të përcaktuar me ligj;
- Hartimi i projekteve;
- Mbikëqyrja e projekteve;
- Përfundimi i ndërtesës për banim social në Rahovec;
- Përfundimi i kompleksit të dëshmorëve në Gradish;
- Rregullimi i varrezave, busteve, pllakave përkujtimore të dëshmorëve dhe martirëve në komunën e Rahovecit;
- Krijimi i një plani në bashkëpunim me Drejtorinë për Punë Inspektuese për rritjen e të hyrave nga lejet ndërtimore dhe lejet mjedisore komunale.

DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Fillim të vitit të ri me qasje në detyrat e reja si dhe përballje me obligimet e mbetura nga viti paraprak.

Qysh në fillim të vitit 2018 do t'i qasemi punës në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara nga Kryetari i Komunës në përputhje me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale dhe Statutin e Komunës së Rahovecit.

Prioritet kryesor gjatë kësaj periudhe një vjeçare, do të jetë i fokusuar në shërbime cilësore në përputhje me afatet kohore dhe të unifikuara ligjërisht. Posaçërisht 6 mujori i parë i këtij viti fokus te veçantë do të ketë ofrimin e shërbimeve në kohë reale për kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për aplikime në Ministrinë e Bujqësisë.

Qëllimi kryesor i drejtorisë është i fokusuar në shërbime konform akteve juridike.

Duhet të theksojmë se në kuadër të drejtorisë ekzistojnë dy sektorë:

- Sektori për Gjeodezi dhe
- Sektori për Kadastër dhe Pronë

Sektori për Gjeodezi

Sektori për Gjeodezi planifikon që të realizojë mbi 400 lëndë.

Planifikojmë që gjatë vitit, sektori i gjeodezisë ta harmonizojë në terren duke u bazuar në kërkesat e palëve, qofshin ato nga persona fizik apo juridik.

Me planin vjetor të punës së kryetarit të komunës do të angazhohemi t'i kryejmë këto punë:

- Prona komunale në ZK. Kramovik, me qëllim të ngritjes së impiantit për pastrimin e ujërave të zeza.
- Prona komunale në ZK. Krushë e Madhe me qëllim të ndërtimit të palestrës sportive.
- Prona private në ZK. Ratkoc për këmbimin e pronës private me pronë komunale në interes të përgjithshëm në raport një me një për projektimin e fushës së sportit.
- Detyrat e tjera të drejtorisë
- Përgatitja e akt dokumentit për angazhimin e gjeodetëve komunalë jashtë drejtorisë.
- Përgatitja e akteve ndaj uzurpatorëve si: Rahovec, Bërnjak, Vrajakë etj.
- Dalja në terren e shërbimit pronëso- juridik, me kërkesë të Drejtorisë për Inspeksion,
- Dalja e gjeodetëve në terren për matjen e rrugëve: Rahovec-Tranzit.
- Matja e lumit Rimnik në Rahovec
- Matjet e pronave private në nivel komune.
- Kufizimi i përrockës në mes fshatrave: Krushë e Madhe dhe Celinë

Sektori për Kadastër dhe Pronë

Sektori për Kadastër dhe Pronë, gjatë periudhës një vjeçare parasheh të pranojë mbi 1,000 lëndë.

Duke filluar nga muaji janar, presim të përballemi me kërkesa për nxjerrjen e certifikatave pronësore nga ana e fermerëve për aplikim në kuadër të subvencioneve që pritet t’ju ndajë Qeveria e Kosovës, po ashtu pas subvencioneve qeveritare presim qe fluksi të mos ndalet edhe gjatë aplikimit për grante komunale.

Do të përgatitet një raport detal në lidhje me pronat e uzurpuara në nivel komune.

Synojmë të evidentojmë dokumentacion të nevojshëm në lidhje me evidentimin e pronave, si ato komunale dhe ato private ku janë vend-rëniet e dëshmorëve të kombit me qëllim që këto parcela t’i shpallim zona me interes të veçantë, e kjo mbetet sfidë që ato të përfundohen deri në fund të vitit 2018.

Do të incizohet gjendja faktike e rrugës transite dhe do të përgatisim elaborate të të gjitha pronave private për shpronësim.

Gjatë kësaj kohë nuk do të mungojë edhe qasja ndaj detyrave të tjera, si në sektorin e gjeodezisë ashtu edhe në atë të kadastrës dhe pronës, ku vlen të ceken:

- Propozim-vendimet për seancat e Kuvendit Komunal
- Përgatitja e lëndëve për gjykatë dhe subjekteve të tjera të përfshira në zbatimin e ligjit.
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe personave juridik.
- Punët e gjeodezisë, inxhinierisë për nevojat e Kuvendit Komunal dhe palëve të tjera
- Matjet kadastrale për vërtetimin e uzurpimeve arbitrare,
- Përgatitja e aktvendimeve për uzurpimet arbitrare.

Synimet dhe sfidat

Sfidat e vitit 2018 për drejtorinë janë:

- Formimi i komisionit për komasacion dhe
- Migrimi i zonave kadastrale të cilat nuk janë të migruara në hartën kadastrale të Kosovës, siç janë: zona kadastrale Dobidol, Xërxë, Bellacërkë dhe Celinë.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Për gjysmën e parë të vitit 2018 planifikojmë që të arrijmë këto prioritetet sipas planit të punës:

- Pastrimin e rrugëve dhe trotuareve nga bora dhe intervenimet e tjera emergjente;
- Intervenimet emergjente pas reshjeve eventuale të shiut;
- Mirëmbajtjen e rrugëve me zhavorr;
- Ndërtimin e rrugëve në qytet sipas prioritetëve;
- Mirëmbajtjen e kanalizimeve dhe ndërhyrjet emergjente në disa vendbanime të komunës së Rahovecit;
- Heqjen e deponive ilegale të inerteve;
- Përcaktimin e lokacionit për legalizimin e deponive për mbeturina të ngurta;

- Analizimin e kontratave dhe përmbushjen e tyre në projektet si: trotuare, rrugë, rreth-rrotullime, hapësira publike, mbikëqyrjen dhe mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, të martirëve, të civilëve, po ashtu, të shesheve, pllakave përkujtimore, të hapësirave të gjelbëruara etj;
- Zhbllokimin e kanalizimeve të ujërave atmosferik;
- Hartimin e projekteve të reja për ndërtimin e rrjeteve të kanalizimit, të rrugëve, ndriçimit publik etj,
- Vazhdimin e ndërtimit të dy rreth-rrotullimeve në hyrje-dalje të qytetit të Rahovecit;

Plani i drejtorisë për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2018:

- Mbledhja e të hyrave nga sipërfaqet publike sipas rregullores së DSHP-së;
- Mirëmbajtjen e hapësirave publike, shesheve, parqeve, varrezave, pllakave përkujtimore, lapidareve etj;
- Mirëmbajtjen e rregullt të kanaleve të ujërave fekale nga kompania KRU-Gjakova;
- Hapjen e procedurave për disa punë si: rrugët lokale qytet-fshat, përmirësimi i kanalizimeve, furnizimin me ujë të pijshëm, mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe atyre në qytet, muret mbrojtëse etj;
- Ndërtimin e rrugës Krushë e Madhe –Randobravë;
- Ndërtimin e rrugës Rahovec-Potoqan si dhe për Fortesë;
- Ndërtimin e rrugëve në Drenoc si dhe disa pjesëve të kanalizimit;
- Ndërtimin e kanalizimit fekal në Çifllak dhe të një segment për ujë të pijshëm;
- Përmirësimin e kanalizimeve në Ratkoc;
- Pas proceduarve për shpronësim, të rifillojmë me ndërtimin e rrugës qarkore;
- Fillimin e punëve me projektin për sinjalizim horizontal dhe vertikal;
- Vendosjen e disa pengesave në rrugë sipas standardeve të përcaktuara;
- Intervenime emergjente në infrastrukturë;
- Inicimin, analizimin e madhësisë dhe dendësisë së qarkullimit në rrugët e qytetit për verifikimin e senseve të lëvizjes;
- Ndriçimin publik në qytet dhe fshatrat më të mëdha të komunës sonë;
- Trajtimin, largimin e qenve endacak në bazë të marrëveshjes së AVUK-it me kompanitë private të licencuara për trajtimin e tyre;
- Stacionin e autobusëve, fillimin e punës së komisionit ;
- Caktimin e lokacionit të deponisë për mbeturina nga demolimet dhe ndërtimet;
- Eliminimin e të gjitha deponive ilegale- inerteve;
- Në bashkëpunim me KEDS do të caktojmë prioritet për shtrirjen e rrjetit elektrik si dhe vendosjes së trafave sipas kërkesave të qytetarëve;
- Përgatitjen në fund-vit për mirëmbajtjen e rrugëve gjate sezonit dimëror.

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Drejtoria për BPZHR, për vitin 2018 ka paraparë rritjen e kapaciteteve prodhuese, modernizimin e bujqësisë, tërheqjen e investimeve, zbatimin e projekteve të hartuara gjatë planifikimit, me qëllim të rritjes së mirëqenies, rritjes ekonomike dhe të punësimit, e që do të realizohen përmes:

- Shërbimeve këshillimore,
- Subvencionimit të fermerëve,
- Implementimit të projekteve kapitale në bujqësi,
- Zbatimin e projekteve të donatorëve dhe mbështetjes direkte në lëmin e bujqësisë për iniciativat e qytetarëve në ngritjen e cilësisë dhe sasisë së prodhimeve bujqësore.

Bashkëpunimi me institucionet qeveritare dhe joqeveritare (vendore dhe ndërkombëtare) dhe me biznesin e brendshëm e të jashtëm drejt realizimit të projekteve zhvillimore komunale për një ambient të mirë të zhvillimit ekonomik – bujqësor, si dhe krijimin e infrastrukturës ekonomike dhe turistike.

Përveç aktiviteteve të parapara për periudhën kohore janar-dhjetor 2018, stafi i drejtorisë për BPZHR do të jenë të angazhuar edhe në komisione të ndryshme për mbikëqyrjen dhe pranimë teknike të projekteve kapitale pranë kësaj drejtorie si dhe komisione të tjera pranë Kuvendit Komunal të Rahovecit.

Përgatitjen dhe mobilizimin e stafit ekzistues për plotësimin e nevojave të drejtorisë si me material administrativ po ashtu edhe me pajisje të nevojshme, në mënyrë që kur të bëhet thirrja për aplikime për pagesa direkte, fermerët ta kenë sa më lehtë dhe mos të ketë pritje të gjata. Sipas nevojës është paraparë që stafit ekzistues t'i bashkohen edhe disa punëtorë shtesë, në mënyrë që procesi i aplikimit të fermerëve të mos ketë ngecje dhe të kryhet brenda afatit të paraparë, meqë në komunën tonë për dallim me komunat e tjera, kemi numër më të lartë të fermerëve.

DBPZHR prioritetin e saj do ta ketë në këto pika si më thelbësore:

- Shqyrtimin dhe vlerësimin adekuat i të gjitha kërkesave dhe dhënia e përgjigjeve me kohë,
- Organizimin dhe mbajtjen e shërbimeve këshillimore për të gjithë fermerët,
- Kërkesat për zotimin e mjeteve buxhetore dhe mbikëqyrjen e implementimit të projekteve në vazhdim si dhe për projekte të reja,
- Bashkëfinancimi i projekteve qeveritare, organizatave ndërkombëtare apo vendore,
- Mbikëqyrja e fushatës së korrje-shirjes,
- Vlerësimin dhe kompensimin e rasteve emergjente në bujqësi të krijuara nga fatkeqësitë natyrore.

Fokusi i drejtorisë së bujqësisë për vitin 2018 do të jetë koordinimi i qendrave grumbulluese dhe përpunuese të perimeve dhe fermerëve, në mënyrë që produktet bujqësore të plasohen me lehtësi në tregun vendor si dhe krijimin e mundësive që produktet bujqësore të eksportohen në tregun e jashtëm.

Synimet e DBPZHR-së

Përkushtim i veçantë i DBPZHR-së do të jetë përmirësimi i infrastrukturës bujqësore për fermerët e vyeshëm të komunës sonë, në kuadër të infrastrukturës parashihet që kujdes i shtuar do të jetë te:

- Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore,
- Intervenimi në ndërtimin e kanaleve të kullimit dhe drenazhimit të tokave bujqësore,
- Zgjerimi i sistemit të ujitjes në pjesët ku mungon,
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e përroskave.

Sektori i pylltarisë

Në kuadër të sektorit të pylltarisë fokusi do të jetë:

- Mbrojtja e pyjeve;
- Rritja e sipërfaqeve me pyje të reja;
- Bashkëpunim i qëndrueshëm me Agjencinë Pyjore të Kosovës për pronat që janë dhënë në shfrytëzim;
- Angazhim maksimal në parandalimin e zjarrvënësve në bashkëpunim me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Sektori i zhvillimit rural

Edhe zhvillimit rural do t'i jepet rendësi e veçantë duke u nisur nga fakti se komuna jonë njihet si një zonë me zhvillim të theksuar rural.

Me kujdes të veçantë do të trajtohen aspektet për trajtim dhe mbrojtje të faunës e cila është mjaft e pasur, falë rrjedhave të shumta të ujërave në tërë territorin e komunës sonë.

Gjuetia dhe peshkataria do të jenë dy fusha që do të kenë vëmendje të shtuar në planet tona afatgjatë.

DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

Plani i punës Janar-Dhjetor 2018 është i bazuar në ligjet që janë në fuqi, udhëzimet administrative dhe rregulloret e komunës së Rahovecit sipas departamenteve gjegjëse.

Planifikohet që të bëhet një ristrukturim i stafit të inspektorëve dhe duke u bazuar në ligjet aplikative të kryhen inspektive, në mënyrë që qytetarët e komunës të jenë më të sigurt në atë që konsumojnë.

Inspektorati i tregut

Në kuadër të inspektimit të tregut planifikohet që të realizohen mbi 1,000 inspektime në tërë territorin e komunës. Do të hartohet një plan i veprimit dhe herë pas here do të ndërmerren aksione për inspektime specifike.

Inspektorati i ndërtimit

Padyshim që fokus i sektorit të ndërtimit do të jetë parandalimi i ndërtimeve pa leje. Do të punojmë ngushtë me drejtorinë e Urbanizmit që numri i lejeve të ndërtimit të rritet. Synojmë që të gjithë qytetarët që do të ndërtojnë t'i përmbahen kushteve dhe planeve që janë në fuqi.

Inspektorati i bujqësisë dhe veterinës

Ky sektor do të punojë ngushtë me drejtorinë e bujqësisë, në zbatim të programit të qeverisjes komunale. Do të synojmë që të gjitha komisionet që do të formohen të jenë të përfshirë edhe inspektorët e kësaj fushe.

Në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës (AVUK) të kemi një kontroll më të rreptë të origjinës dhe cilësisë së mishit si dhe produkteve të tjera që konsumojmë nga sektori agrar.

Sektori i komunikacionit

Në bashkëpunim me drejtorinë e Shërbimeve Publike do të synohet që komunikacioni në komunën e Rahovecit, me theks të veçantë, në qytet të jetë më i qasshëm për të gjithë qytetarët pa dallim. Do të ndërmarrim aksion së bashku me Policinë e Kosovës që automjetet në tërë komunën e Rahovecit, të mos bllokojnë rrugët dhe trotualet. Po ashtu kujdes të shtuar do të kemi në kontrollimin e të gjitha makinave lëvizëse, me theks të veçantë, në makineritë e rënda që qarkullojnë në rrugët e komunës sonë.

Inspektorati për mbrojtje të ambientit

Ambienti në planin tonë të punës do të ketë trajtim të veçantë. Qysh në fillim në bashkëpunim me drejtorinë e Shërbimeve Publike do të identifikojmë të gjitha deponitë ilegale të inerteve dhe do të sigurohemi që këto deponi t'i trajtojmë në mënyrë sa më të mirë.

Do të iniciojmë procedura të identifikimit të lokacioneve të përshtatshme që do të shfrytëzohen për deponi, po ashtu do të ndërmarrim masa që qytetarët e pandërgjegjshëm të ndëshkohen për mos respektim të rregulloreve dhe ligjeve në fuqi.

Do të fokusohemi në fushata sensibilizuese për informim të qytetarëve për një ambient të pastër.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Plani i punës në drejtorinë tonë do t'i mbulojë aktivitetet në Kulturë, Rini dhe Sport. Me këtë plan janë të parapara, aktivitete të përbashkëta me të gjithë në përmirësimin e jetës shoqërore, respektivisht: kulturore, rinore dhe sportive, me potencialin që e posedojmë dhe me kontributin e të tjerëve, që kanë të njëjtin qëllim.

Objektivi i përgjithshëm në Kulturë, Rini dhe Sport

Në kuadër të drejtorisë për KSR, do të angazhohemi në hartimin dhe zbatimin e politikave zhvillimore në fushën e artit skenik, muzikor, arteve pamore, bibliotekare, ruajtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore sipas standardeve të kërkuara, duke konsideruar kulturën si një mekanizëm të fuqishëm për zhvillimin e kulturës në komunën tonë, si dhe për afirmimin e identitetit kulturor në Rahovec, në Kosovë dhe rajon.

Spektori i Kulturës

Plani i punës mbështet, koordinon dhe ndjek ecurinë e zbatimit të projekteve kulturore dhe artistike të elaboruara nga stafi i drejtorisë, në të mirë të njohjes së vlerave më përfaqësues të artit dhe kulturës së shkruar të komunës sonë.

Spektori i Kulturës në bashkëpunim me strukturat e komunave të tjera do të ndikojë drejtpërdrejt në ndërtimin dhe realizimin e programeve të përbashkëta në fushën e arteve skenike-muzikore dhe pamore, botimeve, bibliotekarisë, me qëllim të koordinimit të mëtejshëm të politikave për integrimin e kulturës së komunës sonë, e më gjerë.

Spektori i Rinisë

Prioritet i yni në vitin 2018, do të jetë zhvillimi institucional i nivelit lokal dhe krijimi i strukturës së zyrtarëve komunal për rini që do të jenë të angazhuar për të identifikuar problemet dhe interesimin e të rinjve me qëllim të koordinimit të angazhimeve në sektorin e rinisë.

Ne mendojmë që këto vite, do të karakterizohen me prezencë të konsiderueshme të organizatave ndërkombëtare joqeveritare të cilat e ndihmuan dhe do ta ndihmojnë Sektorin e Rinisë në komunë dhe në veçanti në rindërtim të infrastrukturës dhe programeve socio-ekonomike.

Numri i organizatave që do të ofronin shërbime për rininë dhe sasia e investimeve gjatë viteve të ardhshme, do t'i konsolidonte disa nga përvojat më të suksesshme të ngritura më parë në zhvillimin e politikave rinore e cila shpresojmë se do të jetë në vazhdimësi në mbështetjen për zhvillimin e aktiviteteve për të rinjtë dhe integrimin socio-ekonomik të tyre.

Koordinim të vazhdueshëm me organizatat, klubet, qendrat rinore, OJQ-të në të cilat të rinjtë e komunës sonë kanë mundësinë të zhvillojnë aktivitete të ndryshme kulturore dhe rekreative.

Spektori i Rinisë do të angazhohet për fuqizimin e të rinjve dhe krijimin e mjedisit përkrahës për zhvillimin shoqëror dhe personal të tyre, krijimin e mundësive për promovim, zhvillim dhe pjesëmarrje të të rinjve

në jetën aktive shoqërore, si dhe ofrimin e shërbimeve të barabarta për të rinjtë, që mundësojnë zhvillimin e shkathtësive jetësore dhe vlerave shoqërore, duke respektuar veçoritë individuale të të rinjtë..

Qasja në Arsim, integrimi dhe punësimi: si qëllim do të ketë bashkëpunimin me departamentet e tjera administrative, me komunat, me agjencitë e tjera ndërkombëtare dhe qeveritare si dhe me organizatat joqeveritare për të çuar përpara zhvillimin dhe zbatimin koherent të politikave dhe resurseve të rinisë në çështjet që kanë të bëjnë me: trajnimin për vende të punës dhe për shërbime zanatesh, sportin dhe veprimtaritë rekreative, programet e këmbimit rajonal dhe ndërkombëtar, shëndetësinë dhe arsimin, drejtësinë për të miturit, si dhe përparimin e të drejtave të rinisë.

Zbatimi i strategjisë dhe planit të punës për sektorin e rinisë, realizimi i një analize gjithëpërfshirëse të gjendjes së sektorit të rinisë, duke përfshirë legjislacionin, institucionet, programet dhe veprimtaritë tjera, identifikimi i grupeve të caktuara të rinisë të cilat do të merren me zhvillimin e programeve për t'u marrë me nevojat e tyre, duke përfshirë grupet e rinisë jashtëshkollore, rininë analfabete, rininë e papunësuar, rininë refugjate të kthyer etj.

Aktivitetet 2018:

- Manifestimi kulturor, përkujtimor "Flaka e Janarit" - 2018
- Shfaqje teatrale në artin skenik si: dramë, komedi, skeçë, film dokumentar etj.
- 17 shkurti, organizimi i 10 vjetorit të pavarësisë së Kosovës.
- Shënimi i 21 marsit, Ditës Ndërkombëtare të poezisë.
- Zgjedhjet në Këshillin Rinor Lokal, shkurt 2018; DKRS dhe Qendra rinore
- Debat me të rinjtë rreth vullnetarizmit, shkurt 2018; DKRS dhe Qendra rinore
- Dita Botërore e gjuhës amtare, shkurt 2018 DKRS & QR & DKA
- Dita Botërore e Scout (që mbështet të rinjtë në zhvillimin fizik, mendor e shpirtëror)
- Përgatitje për projektin "Të rinjtë dhe libri", shkurt-mars 2018; DKRS & QR & DKA.
- Debatet: prindër-nxënës-shkollë-komunitet; mars 2018; DKRS & QR & DKA.
- Dita Botërore e Teatrit për Fëmijë dhe të Rinj; 20.03.2018; Qendra Rinore dhe DKA.
- Dita Botërore e Informimit, 24.03.2018; DKRS & Zyra e Kryetarit & QR.
- Dita Botërore e Dramës, 27.03.2018; DKRS & QR & Shoqëria civile.
- Restaurimi i monumenteve kulturo-historike.
- Maj, organizimi i Festivalit Folklorik Kombëtar "Anadrinia jehon 2018".
- Maj, shënimi i Ditës së Qendrës së Kulturës "Mensur Zyberaj".

Dita e çlirimit të komunës sonë, shënimi i përvjetorëve të betejave dhe rënieve të dëshmorëve, organizimin e festës tradicionale të vjeljes së rrushit, (Hardh Fest), organizimi i aktiviteteve në "Muajin e Mërgimtarëve", organizimin e manifestimeve kulturore në kuadër të shënimit të Vitit të Skënderbeut, si dhe shënimin e përvjetorëve të lavdisë e krenarisë tonë kombëtare.

DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Në kuadër të drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, plani i punës për vitin 2018 bazohet në këto prioritetet:

- Inspektimi i lumenjve, përrenjve dhe kanaleve të hapura
- Plani i reagimit emergjent
- Kontrolli i radio-lidhjeve, azhurnimi i frekuencave
- Inspektimi i rregullt i objekteve publike
- Inspektimi i rregullt i objekteve ekonomike dhe private
- Inspektimi i objekteve shëndetësore
- Inspektimet verifikuese, kontrolli i eliminimit të mangësive
- Regjistrimi i mjeteve teknike të nevojshme për intervenime në raste emergjente.
- Përcjellja e gjendjes së gatishmërisë dhe organizimi në hapësirën e mbrojtjes dhe shpëtimit si dhe intervenimi në raste të zjarreve dhe vërshimeve.
- Pajisja me uniforma për zjarrfikësit dhe pajisjeve përcjellëse për zjarrfikësit.
- Servisimi i aparateve kundër zjarrit
- Koordinimi i aktiviteteve nga fusha profesionale
- Verifikimi i përgatitjeve për intervenim të forcave dhe të mjeteve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë
- Zhvillimi i aktiviteteve propagandistike në edukimin dhe vetëdijshmin e popullatës për mbrojtjen eventuale nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera
- Bashkëpunimi me sektorë, shërbime e zyre të ndryshme të cilat janë përgjegjëse për planifikim dhe veprim në emergjencë
- Ndërtimi i Infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore tek objekti i zjarrfikësve
- Trajnime në qendrën për trajnim të integruar në Vushtrri.

Janar, 2018

